



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF
GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Projekt

R R E G U L L O R E

**MBI NDRYSHIIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE
TE ADMINISTRATËS KOMUNALE NR. 01. NR. 8355 TË DT. 09.07.2010**

Gjilan, qershor 2015

Në pajtim me nenin 12 shkronja c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nën-kreut 4 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 82/2010), nenit 46 nënparagrafi 2.1 dhe në zbatim të nenit 84 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit me _____, miraton këtë:

Rregullore

mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale nr. 01. nr. 8355 të dt. 09.07.2010

Neni 1.

1. Nën nenin 1 të rregullores bazë, shkruhet fjala “Qëllimi”
2. Neni 1 i rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin e organeve të administratës së komunës, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre”.
3. Nën nenin 2 të rregullores bazë, shkruhet fjalia “Strukturat përbërëse komunës” dhe paragrafi 1 i nenit 2 të rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: “Strukturat përbërëse të komunës janë: Drejtoritë, sektorët brenda drejtorive, njësitë dhe zyrat”.
4. Paragrafi 2 i nenit 2 të rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: “
 - 2.1. Drejtoria është struktura bazë e komunës. Ajo është përgjegjëse për fushën e drejtimit që mbulon në kuadër të komunës.
 - 2.2. Sektori është struktura bazë dhe më e specializuar për elementët e veçantë të një fushe drejtimi. Ai mund të jetë brenda një drejtorie ose i pavarur, kur fusha që mbulon nuk ka lidhje me natyrën e punës së drejtorisë, por luan rol të rëndësishëm në plotësimin e misionit të strukturës së komunës.
 - 2.3. Zyrat dhe njësitë janë pjesë përbërëse të administratës së komunës, të cilat mbulojnë aspekte të veçanta të veprimtarisë dhe përgjigjen për fushën që mbulon”.
5. Paragrafi 1 nenit 3 të rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: “Drejtoritë, njësitë dhe zyrat janë të përcaktuara me statut të komunës dhe me organogram”, kurse paragrafi 2 i këtij neni fshihet.
6. Titulli para nenit 4 i rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: Menaxhimi dhe udhëheqja me organet e administratës” dhe i njëjti shkruhet nën nenin 4.
7. Paragrafët: 1,2 dhe 3 të nenit 4 të rregullores bazë, riformulohen dhe kanë përmbajtjet si në vijim:
 1. “Me çdo drejtori menaxhon dhe udhëheq drejtori i cili përgjigjet dhe raporton Kryetarit të Komunës”,
 2. “Me çdo sektor brenda drejtorisë përkatëse udhëheq shefi/udhëheqësi i cili përgjigjet dhe raporton drejtorit të drejtorisë përkatëse”,
 3. “Me punën e njërive dhe zyrave udhëheqin shefat/udhëheqësit e tyre të cilët i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës”.
8. Paragrafi 4 i nenit 4 të rregullores bazë, fshihet.
9. Neni 5, 6,7 dhe 8 të rregullores bazë, fshihen.

Neni 2.

1. Titulli para nenit 9 të rregullores bazë, titulli ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorive, zyrave, njësive dhe departamentit të prokurimit ” dhe të gjitha paragrafët e nenit 9 shndërrohen në nene sipas radhës.
2. Te neni 9 paragrafi 1 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka në objekt të punës së saj:”
 - Te neni 9 paragrafi 2 i rregullores bazë, pasusi i parë ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka në objekt të punës së saj:” dhe shtohet kjo kompetencë si në vijim: “Bënë kontrollimin dhe inspektimin në lëmin e sanitarisë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi”.
3. Te neni 9 paragrafi 4 i rregullores bazë, emërtimi ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Drejtoria për buxhet dhe financa” dhe fshihet pasusi i fundit “Aktivitetet tjera”.
 - Te neni 9 paragrafi 5 të rregullores bazë, emërtimi ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit”. Dhe shtohet kjo kompetencë si në vijim: “Bënë kontrollim dhe inspektimin në lëmin e ndërtimit dhe të mbrojtjes së ambientit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore”.
4. Te neni 9 paragrafi 6 të rregullores bazë, emërtimi “Drejtoria e inspeksionit” fshihet.
5. Te neni 9 paragrafi 7 i rregullores bazë, emërtimi “Drejtoria e shërbimeve publike” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria për Shërbime publike, Infrastrukturë dhe Banim” dhe ka këtë përmbajtje:

“Drejtoria për Shërbime publike, Infrastrukturë dhe Banim ka në objekt të punës së saj:

1. furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) dhe përpunimin e ujërave të zeza;
2. organizon mirëmbajtjen verore dhe dimërore, pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit dhe rrugëve lokale;
3. organizon menaxhimin e parqeve publike, shesheve, hapësirave gjelbëruese, hapësirave publike dhe varrezave;
4. koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve individual dhe operatorëve juridik sipas rregulloreve;
5. cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve;
6. bën menaxhimin e shërbimit me “Merimangë”, sipas rregullores, si dhe organizon procedurat për ankand publik për automjetet e konfiskuara, që kalojnë afatin e paraparë me ligj;
7. bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
8. bën sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe rregullon komunikacionin në territorin e komunës.

9. bën mbylljen e rrugëve për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);
10. bashkëpunon me kompanitë që ofrojnë shërbime rreth grumbullimit të mbeturinave, furnizimit me ujë, furnizimit me rrymë, postën etj;
11. është përgjegjëse për ndriçimin publik, tabelat reklamuese dhe reklamat e ndryshme;
12. merr pjesë në komisionet për pranim teknik të projekteve të infrastrukturës dhe banimit;
13. është përgjegjëse t'i ofrojë raporte vjetore MAPL-së për shërbimet që i ofrohen qytetarëve në kuadër të kompetencave të Drejtorisë;
14. bën konsultimet me nivelin qendror për ndërtimin, riparimin e shenjave apo ndryshimin e rrugëve ndër-komunale që ndikojnë në komunë;
15. harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, duke marrë parasysh nevojat e banorëve dhe duke bashkëpunuar me bashkësitë lokale, krahas zhvillimit urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale, ku njëherësh edhe propozon realizimin e tyre;
16. përcjellë dhe studjon rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës me pikësynim zhvillimin e infrastrukturës sipas normave të BE-së;
17. përgatitë detyrat projektuese për projektet e drejtorisë dhe në raste të veçanta harton paramasa;
18. lëshon leje për ndërhyrje në infrastrukturën publike komunale, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike (PTK-ja, KEDS-i, KRU "Hidromorava") dhe kyçjet individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
19. arkivon dokumentacionin teknik të infrastrukturës lokale;
20. bashkëpunon me bashkësitë e pronarëve lidhur me funksionimin praktik të bashkëpronësive duke u mbështetur në dokumentacionin teknik që ekziston;
21. mbanë regjistrin e ndërtesave në bashkëpronësi dhe bashkëpunon me administratorët që ushtrojnë këtë veprimtari;
22. bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror-Divizionin e Banimit, siguron edukim dhe trajnimin e administratorëve të ndërtesave dhe kryesinë e shoqatës rreth qeverisjes dhe funksionimit të ndërtesës në bashkëpronësi;
23. bën mbikqyrjen inspektuese me autorizim të posaqëm si inspektor për banim;
24. inspekton lidhjen pa leje në rrjetin e ujësjellësit publik nga ana e personave fizikë dhe juridikë, mbikëqyrë dhe parandalon keqpërdorimin e ujit të pijshëm për larjen e rrugëve, sipërfaqeve publike, autolarje, mbushjen e puseve, ujitjen e kopshteve etj;
25. inspekton lidhjen ilegale në rrjetin e kanalizimit publik, mbikëqyrin ndërhyrjen (prerjen) e rrugëve publike pa leje, të trotuareve dhe të sipërfaqeve tjera publike;
26. inspekton mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve tjera publike, inspekton hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, inspekton zbrazjen pa leje të materialeve (rërës, dheut, të materialit tjetër ndërtimor) që pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve;
27. Inspekton ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste në hapsira publike, ndalimin e shfrytëzimit (vendosjes) pa leje të hapësirave publike, vënien e

- mbishkrimeve, panove dhe reklamave, vitrinave, objekteve publike dhe higjienike, hoteliere, sallave publike (WC-të);
28. inspekton zbatimin e dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit të mjeteve motorike në qarkullimin rrugor;
 29. inspekton kontrollimin dhe marrjen e masave të parapara ligjore kundër operatorëve ilegal dhe të atyre legal që nuk respektojnë orarin e përcaktuar nga organi kompetent;
 30. ushtron kompetencat tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse, statut, rregulloret komunale si dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 3

Neni 9 paragrafi 8 i rregullores bazë, ka këtë përmbajtje:

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka në objekt të punës së saj:

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Institucionet tjera relevante ushtron përgjegjësi që i ka komuna në lëmin e bujqësisë në kuptim të gjerë, pylltarisë, resurseve natyrore dhe zhvillimit rural.
2. Përcjell dhe koordinon zbatimin e ligjeve në lëmin e bujqësisë duke përfshirë prodhimtarinë bimore, blegtorale, resurset natyrore, dhe zhvillimin rural në territorin e komunës.
3. Bënë nxitjen dhe inkurajimin e fermerëve për të investuar në rritjen e kapacitete të tyre bujqësore.
4. Organizon seminare, këshillime etj. me qëllim të formimit profesional të fermerëve.
5. Organizon vizita studimore për fermerët, brenda dhe jashtë vendit për këmbimin e përvojave të tyre.
6. Merr masa për vetëdijesimin e institucioneve relevante për rendësin që ka bujqësia për zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit, zvogëlimin e problemeve sociale, sigurimin e ushqimit të mjaftueshëm, të freskëte dhe cilësor, sigurimin e lëndëve të para për zhvillimin e industrisë ushqimore, për përmirësimin e bilancit tregtarë si dhe mënyrën se si duhet qasur asaj.
7. Mban evidencë për tokat bujqësore, llojet dhe sipërfaqet me kultura bujqësore, llojet, kategoritë dhe numrin e krerëve të kafshëve shtëpiake, shoqëritë e bletëve etj.
8. Analizon potencialin e fermerëve, nevojat dhe mundësit e zhvillimit të mëtejme të tyre, rekomandon masat adekuate dhe hulumton mundësit për mbështetje profesionale, administrative dhe material.
9. Hulumton mundësit për sigurimin e tregut për tërë prodhimtarinë bujqësore.
10. Përkujdeset të sigurojë që toka bujqësore të shfrytëzohet për prodhimtari të qëndrueshme bujqësore.
11. Monitoron menaxhimin e vendgjuetive dhe organizimin e gjuetisë në territorin e komunës.
12. Ndërmerr masa për mbrojtjen e prodhimtarisë bujqësore nga fatkeqësitë elementare (vërshimet, breshëri, zjarri, pandemitë etj).
13. Në rast fatkeqësie elementare bëjnë vlerësimin e dëmit dhe propozon rekomandimet për masat e mëtejme.
14. Bën projekte dhe hulumton donator për realizimin e tyre.
15. Bënë mbrojtjen e tokave bujqësore si dhe resurseve të tjera natyre nga degradimi.

16. Bënë kontrollin dhe inspektimin në lëmin e bujqësisë.

17. Kontrolli i hapësirave afariste, objekteve, pajisjet, prodhimin, qarkullimin dhe transportin e mallrave me origjinë bimore.
18. Merr masa për ruajtjen e shëndetit publikë dhe urdhëron tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi si dhe asgjësimin e tij.
19. Kontrolli veterinar i objekteve, pajisjeve dhe ushqimeve me prejardhje shtazore.
20. Ndalimi i therjeve ilegale dhe ndalimi i shitjes së mishit të pa damkosur në vende publike.
21. Inspektimin e thertoreve – qertifikimin e mishit për konsum publikë, inspektimin e fabrikave për përpunimin e mishit.
22. Lëshimin e fletë transporteve – qarkullimin e kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës.
23. Damkosja e mishit për konsum, inspektimi i kushteve të prodhimit-përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, mbikëqyrjen e subjekteve tregtare- ushqimore që merren me qarkullimin e produkteve me origjinë shtazore, objekteve hoteliere, tregjeve etj.
24. Koordinon dhe bashkëvepron me OJQ dhe kooperativa që kanë aktivitet bujqësor.
25. Kujdeset për zhvillimin e turizmit rural.
26. Kryen edhe punë të tjera nga kompetencat e komunës në lëminin e bujqësisë, pylltarisë dhe resurseve natyrore.

Neni 4

1. Te neni 9 paragrafi 9 i rregullores bazë, fshihet emërtimi “Drejtoria e Rinisë, Kulturë dhe Sportit” fshihet, kurse kompetencat dhe përgjegjësit e saja inkorporohen në kuadër të Njesisë për Kulturë Rini dhe Sport.
2. Te neni 9 paragrafi 10 i rregullores bazë, emërtimi “Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë”.

Neni 5

Te rregullorja bazë, pas “Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim” shtohet emërtimi “Drejtoria për zhvillim ekonomik”

“Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka në objekt të punës së saj:

1. Hartimi i strategjisë zhvillimore lokale në përputhje me strategjinë regjionale dhe atë qendrore, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë, si në aspektin afatshkurtër edhe në atë afatgjatë;
2. Hartimin e politikave zhvillimore dhe marrjen e masave të përshtatshme për të nxitur më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës;
3. Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme me qëllim të realizimit të projekteve komunale;
4. Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare;
5. Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë;

6. Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave për bizneset lidhur me mundësit për të investuar kapitalin e tyre në veprimtarit prodhuese dhe ku janë mundësit më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve të tyre;
7. Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve dhe të këshillave për to;
8. Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat;
9. Bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe resorëve tjerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth mundësive dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal;
10. Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore;
11. Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore për veprimtari të ndryshme;
12. Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset e Komunës lidhur me përmirësimin e kushteve për biznes përmes mbështetjes së njëra tjetrës;
13. Koordinimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projekteve;
14. Ruajtja e tokës bujqësore nga ndërrimi i destinimit të saj si dhe trajtimi adekuat i tokës bujqësore;
15. Përcjellja dhe zbatimi i politikave dhe programeve zhvillimore, planeve vjetore dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe regjional;
16. Mbajtjen e evidencës për tokën, pronën dhe pasurinë e Komunës;
17. Organizimin e konferencave të ndryshme për mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Komunës dhe regjionit;
18. Organizimin e panairove për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve;
19. Komunikimin e vazhdueshëm me diasporën që të jenë të informuar lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët e mundshëm;
20. Promovimin e turizmit lokal, etj dhe
21. Ushtron detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në fushën e tregtisë, shërbimeve të brendshme dhe mbikëqyrjen e tregjeve në pajtim me ligjin.

Neni 6

1. Te rregullorja bazë, emërtimi i titullit “Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Zyrave, Qendrës për Shërbimet të Qytetarëve-arkivës dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm zëvendësohet me emërtimin “Zyrat, Njësitë dhe Departamenti i prokurimit” dhe të gjithë paragrafët ku janë të përshkruara veprimtaritë të shndërrohen në nene sipas radhës.
2. Te rregullorja bazë, emërtimi “Zyra e kryetarit” zëvendësohet me emërtimin “Kabineti i kryetarit”.
3. Te rregullorja bazë, emërtimi “Zyra e personelit” zëvendësohet me emërtimin “Njësia për personel”.
4. Te rregullorja bazë, emërtimi ”Zyra e përfaqësuesit ligjor të komunës” fshihet dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e saja inkorporohen në kuadër të Zyrën Ligjore.
5. Te rregullorja bazë, emërtimi ”Zyra e prokurimit” zëvendësohet me emërtimin “Departamenti i prokurimit”.

6. Te rregullorja bazë, emërtimi "Zyra për projekte" fshihet.
7. Te rregullorja bazë, emërtimi "Zyra për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut" zëvendësohet me emërtimin "Njësia për të drejtat e njeriut".
8. Te rregullorja bazë, emërtimi "Qendra për shërbime të qytetarëve dhe arkiva" fshihet dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e saj përshkruhen në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme".
9. Te rregullorja bazë, emërtimi "Zyra për komunitete" zëvendësohet me emërtimin "Zyra për Komunitete dhe Kthim".
10. Në vazhdim të radhës të zyrave shtohen edhe emërtimet e reja: "Njësia për Kulturë Rini dhe Sport" dhe "Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc".

Neni 7

Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

1. Angazhohet për bashkëpunim ndërkuftar për çështjet me interes që janë me domethënie për qytetarët e rajoneve .
2. Angazhohet për takime të përbashkëta dhe inkurajon realizimin e projekteve me interes të përbashkët në fushën e kulturës, ekonomisë si dhe në fusha tjera.
3. Identifikon problemet e përbashkëta të qytetarëve në rajone.
4. Angazhohet në shkëmbimin e përvojave për çështje me interes të përbashkët .
5. Kërkon nga niveli qendror trajtim apo zgjidhje të çështjeve që lidhen me bashkëpunimin ndërkuftar në çështje të caktuara.
6. Këshillon qytetarët që përkohësisht jetojnë në këtë regjion për të drejtat e tyre sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Neni 8

1. Para nenit 11 të rregullores bazë, shënohet titulli me këtë përmbajtje: "Dispozitat kalimtare dhe të fundit".
2. Paragrafi 11.1 i rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: "Zbatimin e kësaj rregulloreje e bëjnë drejtoritë, zyrat, njësitë dhe Departamenti i prokurimit në kuadër të Komunës së Gjilanit dhe të gjitha institucionet tjera në vartësi të tyre, kurse mbikëqyrjen e zbatimit e bënë Kryetari i Komunës".
3. Paragrafi 11.3 i rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: "Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Gjilanit".

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01. nr. _____
Gjilan, _____

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku Rexhepi